



Numri: 01-615

18.11.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **27.11.2019** (e mërkurë) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i planit Aksional për të riatdhesuarit;
3. Aprovimi i planit Aksional për Kthim të qëndrueshëm;
4. Pruerja e Vendimit për shitjen e automjeteve të vjetra të në gjendje teknike jo të regullt, në bazë të propozimit nga komisioni për vlerësimin e gjendjes së Automjeteve të Komunës;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 18.11.2019
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 31.10.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Predrag Stojkovic, Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Drejtori i Administratës Driton Abdyl, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Drejtori i Inspeksionit Xhevat Mehmeti, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshëndeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët të Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Prerja e vendimit për bartjen e mjeteve nga kodi buxhetor i zyres së Kryetarit në kodin buxhetor Sherbime Komunale në vlerë prej 15%;
3. Raportim nga Drejtoria e Arsimit rreth transportit të nxënësve dhe bursave për nxënës dhe student;
4. Raport rreth memorandumeve të nënshkruara në mesë të Komunës dhe Hidromoraves (për ujësjellësin në Koretishtë-Pasjak);
5. Raport nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, në lidhje me një numër të madhë të kërkesave të qytetarëve të dorëzuara në Drejtori dhe rreth perfundimit të rrugës në fshatin Pasjak;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Aprovohet rendi i ditës me 14 vota për dhe 1 apstenimi nga të gjithë antarët e Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali me 13 vota për dhe 2 apstenim nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Prerja e vendimit për bartjen e mjeteve nga kodi buxhetor i zyres së Kryetarit në kodin buxhetor Sherbime Komunale në vlerë prej 15%;

Per këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic;

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi që janë planifikuar mjetet për mallra dhe shërbime na duhet një vendim nga Kuvendi që ti bartim këto mjete në shërbime Komunale, me vendim të Kuvendit kemi të drejt që ti bartim këto mjete por është një gabim teknik sa i përket kësaj pike pasi që mjetet do të barten nga Drejtoria e Administrates pasi që për momentin nuk ka mjete në mallra dhe shërbime në zyrë të Kryetarit dhe nuk egziston mundësia që të barten prej zyres së Kryetarit në shërbime Komunale, por këto mjete do të barten nga Drejtoria e Administrates prej kodit 130 në kodin shërbime komunale 132 për arsye se janë disa faktura të rrymes që duhet paguar në shkollë dhe ambulanta dhe pikërisht këto faktura paguhen nga Administrata, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: unë nuk e di se çfarë gabimi teknik mundet me qenë bartja prej zyres së Kryetarit dhe tash të ndrrohet kodi, mendoj se ky është materiali që na ka ardh, unë pajtohem që prej zyres së Kryetarit të mirren 15%, ndërsa prej këtij kodi tjetër ne nuk jemi as të pregaditur dhe nuk e dim arsyetimin e Drejtorit që e dha tash.

Sercan Todorovic tha: dua të them se komunalit merren dhe janë në Drejtori të Administrates dhe nuk ka në zyrë të Kryetarit dhe nuk kemi se çka të bartim si dhe këto faktura të rrymes i paguan Administrata, 12,000€ janë në mallra dhe shërbime në Administrat dhe duhet të kalojnë në shërbime Komunale.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: propozimi i Drejtorit është i qartë edhe pse e ka në rend dite se mjetet do të mirren nga zyra e Kryetarit por mendoj se kur është interesi i qytetarëve tonë duhet ta perkrahim andaj kerkoj nga ju që ta perkrahni, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: në KPF-ë Drejtori ka deklaruar se mjetet do të mirren në zyrë të Kryetarit, e kisha lut Drejtorin që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të konsultohet Drejtori me Kryetarin edhe njëher dhe kur të vij pika të jenë më të sigurt.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe unë jam pjesë e KPF-së, është e vërtetë ajo që e tha Selatini por të njëjten kohë e patëm arsyetimin nga Drejtori se nuk kemi mundësi me i bartë, pasi që është për të mirën e qytetarëve ta perkrahim pjesën më të ndjeshme siç janë nxënësit, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: perseri nuk po pajtohem me materilin dhe piken se si na ka ardh, këtu po bëhet fjalë që të terhiqen mjetet nga zyra e Kryetarit ndërsa tash thuani se nga Administrata, unë nuk e lejoj veten me u mashtrë dhe me u manipulë, unë jam kunder.

Sercan Todorovic tha: mendoj se kam qenë i qartë, në zyrë të Kryetarit nuk egzistojn mjete, këto do të barten nga mallra dhe shërbime në shërbime komunale dhe do të shfrytëzohen për pagesa të rrymes.

Kryesusi e pyeti Drejtorin se a kemi kohë për mbledhjen e ardhshme ta shtym këtë pikë?

Sercan Todorovic tha: nuk ka kohë, pasi që vendimi duhet të mirret dhe të dergohet në Ministri, e mos të viem në atë situat që shkollat të mbesin pa rrymë.

Ramush Mehmeti tha: duke e pasur parasysh se po psojn fëmijët tonë pa dallim etine kërkoj nga kolegt që ta perkrahin pasi që është afati kohor dhe nese se aprovojm sot ato faktura mbesin pa u paguar.

Selatin Nuhiu tha: ne kur e aprovum rendin e ditës kjo pikë është duhur të terhiqet njëher dhe të shtohet pikë tjetër kjo që e propozoj Drejtori.

Xhejlane Behluli tha: perseri secili e kemi të drejten tonë por të votojm ti lëmë inatet personale pasi që është në interes të nxënësve dhe qytetarëve tonë, bëhet fjalë për pagesa të rrymes në shkollë dhe ambulanta.

Kryesuesi tha: nuk e di a është në rregull ashtu si tha Selatini a duhet të terhiqet kjo pikë ta pyesim perfaqësuesin e OSBE-së, ai po thot se nuk ka nevoj të terhiqet pika.

Jahi Zeqiri pasi pershendeti të pranishmit tha: kjo punë po shihet qarët që është në interesin e të gjithëve me kalu, Drejtori është mirë me kërku falje mos me ndodh më gabime teknike herav tjera, mirë ish kan mi lënë anash inatet politike e me votu në mënyrë që mos të mbesin shkollat pa energji elektrike, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: prej parafolësvo po duket se arsyetimi im është kunder dikujt por unë nuk kam inate personale me askend, mendoj se duhet reaguar antarët e KPF-së që e kan votuar këtë pikë për ta sjell në

Kuvend, mos të bien pika e mandej të ndryshohet komplet teksti, nuk mundemi të manipulojm kur kemi diçka tjetër në rend dite e diçka tjetër kerkohet në seanc.

Xhejlane Behluli tha: perderisa propozuesi i kësaj pike ka qenë prezent edhe në KPF dhe të njejten kohë po merr pjesë në Kuvend dhe po e prezanton gabimin dhe po e arsyeton ne duhet ta perkrahim.

Fasi nuk pati diskutime tjera Kryesusi e hudhi në votim.

Me 13 vota për, 2 kunder (Abdyll Gashi, Selatin Nuhui) nga antarët prezent të Kuvendit aprovohet ky:

VENDIM

Me këtë vendim barten mjetet financiare nga kodi buxhetor i Administrates 16330 në vlerë prej 15% nga vlera totale nga kodi mallra dhe sherbime 130, në nën kodin sherbime Komunale 132.

Pika e tretë: Raportim nga Drejtoria e Arsimit rreth transportit të nxënësve dhe bursave për nxënës dhe student;

Kryesusi tha: në mbledhje të KPF-së zt.Selatin ka kerkuar raport nga Drejtoria e Arsimit lidhur me qështjen e transportit të nxënësve pasi që një kohë nxënësit nuk kan transport por si duket nuk është askush prezent nga Drejtoria e Arsimit që të na informoj, e hapi diskutimin nese ka dikush të paraqes diçka.

Selatin Nuhui tha: afer 3 jav nuk kemi transport të nxënësve dhe dihet se çfarë Komune specifike jemi ne pasi kemi një distanc me shkollat dhe një pjesë e madhe e nxënësve nuk kanë mundur ta vijojn mësimin, kjo është një neglizhenc duke filluar nga Kryetari i Komunës dhe gjithë administrata Komunale, është faji i tyre që nuk i kan kryer procedurat e tenderit me kohë. Joseriozitet i Drejtorisë së Arsimit po duket sa që nuk i merr parasysh kerkesat tona dhe nuk kan ardh sot me u arsyetu se pse nuk ka transport, kjo është apsurde dhe nuk ka diçka në Komunën tonë që shkon mirë.

Xhejlane Behluli tha: nuk e di sa jeni inforumar por mbrëm permes mjeteve të informimit jemi informuar se pse ka ngec transporti i nxënësve, andaj është mirë se para se ta ngrismi një qështje të kemi informata të mjaftueshme. Te njejten kohë per rend dite nuk u cek nga Kryesusi por kam kerkuar raport edhe për bursa për nxënës të shkollave të mesme dhe student pasi që e di prej viti 2009-2013 ka pasur bursa dhe në vitin 2014 vetem këtë vit kish pasur në bazë të informatave që i kam marrë, për këtë arsye kam kerkuar një raport se si ka funksionuar ne atë kohë si ka pasur mjete që të ndahen për nxënës dhe student dhe pse tash nuk ka dhe nese ka mundësi me u nda një shume për bursa, ju faleminderit.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: tash ne nuk po e dim se a u zgjedh problemi i transportit të nxënësve apo nuk është zgjedh?.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: të gjithë e dini se që afer 10 vite organizohet transporti i nxënësve edhe këtë vit procedurat kanë filluar me kohë por nganjëher situata nuk varet vetem nga ne, në këtë proces është ankuar padrejtësishtë një kompani nga Gjilani dhe procesi ka ngec tani lenda ka shku në OSHP, ata i kanë proceduart e veta deri ta shqyrtojn ankesen e ta caktojn një ekspert që të vij e të shikoj se si ka rrjedh procesi në pergjethësi e deri sa ta marrin një vendim sigurisht se do të merr kohë dhe ne duke e parë këtë situat pasi që 2 jave nxënësit kanë udhëtuar këmbë, prind kush ka pasur mundësi i kanë bart nxënësit në shkoll por nuk kanë pasur humbje mësimi nxënësit pasi që e kan shfrytëzuar edhe ecjen në këmbë deri të shkolla pasi që nuk është edhe një distanc e madhe e paperballueshme por ne dje me shefin e administrates dhe drejtorin e administrates kemi gjetur një zgjidhje të perkoshme me kompanin që ka operuar deri me tani deri sa të vij lenda prej OSHP-së dhe të zgjidhet ky problem dhe prej ditës së sotme nxënësit e shfrytëzojn transportin sikur që e kanë shfrytëzuar që 10 vite. Sa i perket bursave vertet atëher kush është biseduar për buxhetin është duhur të diskutojmë, të kerkoht që të ndahet një shumë për bursa për nxënës dhe student sepse një kohë siç tha Xhejlanja kur unë kamë qenë Kryetar Komune për çdo vit e kemi nda një shumë dhe ju kemi nda nxënësve dhe studenteve, prandaj nuk e di kjo sot a ka mundësi me u zgjidh por për momentin nuk ka fonde të ndara për bursa dhe student, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: për këtë pikë paskan qenë dy propozime, sa i perket propozimit të Selatinit ka qenë propozim i arsyeshëm, pasi që afer 2-3 jave nxënësit nuk kanë pasur transport, mirë që është bë një

zgjidhje e perkoshme, ndërsa sa i perket propozimit për bursa habitem se si një antarë i Kuvendit që është miratues i buxhetit dhe nuk është nda asnjë cent për bursa pyet se pse nuk ka mjete për bursa. Nese ne si antarë të Kuvendit nuk e dim rolin tonë atëher po tregon se ne nuk po e dim se çka po bëjmë, çdo antarë i Kuvendit ka pas të drejt të propozoj ide të ndryshme, çka është në interesin e qytetarëve duhet të ngriten qështje çdo herë, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli tha: unë kam kerkuar raport se pse nuk ka bursa prej viti 2014 dhe si ka funksionuar në atë kohë e pse tash nuk po funksionon, une i kam bërë pyetje direkte edhe zyrtart të arsimit në KPF-ë por ju si lexoni procesverbalet por arsyetimi i tij ka qenë se pjesa më e madhe e buxhetit prej Drejtorisë së Arsimit shpenzohet për transport të nxënësve.

Pika e katërt: Raport rreth memorandumeve të nënshkruara në mesë të Komunës dhe Hidromoraves (për ujësjellësin në Koretishtë-Pasjak);

Kryesusi tha: këtë pikë e ka propozuar Mirjana në mbledhje të KPF-së për problemet me furnizimin më ujë në fshatin Koretishtë dhe ka kerkuar që të prezantohet memorandum i se çka permban por si duket edhe për këtë pikë nuk është askush që ta prezantoj.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: kemi pasur një takim në fshatin Koretishtë para një kohe, ne e kemi ujësjellësin që 5 vite është nënshkruar memorandum i me Hidromoraven por që një kohë nuk po funksionon ujësjellësi dhe nuk po permbushet ai memorandum, e kam pyetur disa herë znj. Shefkije dhe më ka thënë se ka disa borgje në pagesa të rrymes, kemi pasur takim te dielen me Kryetarin dhe Kryetari e na ka thënë se e ka paguar fakturen e rrymes në vlerë prej 1300€ dhe besoj se gjatë ditës do të furnizoheni me ujë. Tani është java e dytë dhe perseri nuk ka ujë, kamë qenë disa herë në Hidromorav ata më kanë thënë se janë duke ja bërë analizat dhe më pastaj kanë konstatuar se uji ka dalë i pijshëm, ne ende nuk kemi ujë dhe nuk e di a egziston ndonjë mënyrë të vendoset diçka për këtë ujë, ose të tregoj ndonjë zyrtarë se pse nuk ka ujë. 6 vite ujësjellësi nuk ka funksionuar por ta dim se cili është problemi, prandaj kemi kerkuar ta shohim edhe memorandum i se si e kanë nënshkruar në çfarë kapacitete, por siç po shihet kjo kërkesë e jonja nuk është marrë parasysh.

Nexhat Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe pse nuk është punë e imja direkte por kam biseduar edhe me Kryetarin dhe jemi marrë me këtë punë, uji nuk do të kalojë më larg se Koretishta dhe Pasjaki dhe besoj se sot pasdite do të keni ujë.

Mirjana Simijonovic tha: po i besoj Nexhatit por perseri insitoj që ta shoh memorandum i, ku është ai memorandum ai duhet të jete edhe ne web faqe të Komunës.

Nexhat Mehmeti tha: Memorandum i është në Hidromorav, besoj se është edhe në Komunë kopje.

Pika e pestë: Raport nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, në lidhje me një numër të madhë të kërkesave të qytetarëve të dorëzuara në Drejtori dhe rreth perfundimit të rrugës në fshatin Pasjak;

Kryesuesi tha: edhe kjo pikë është kerkuar në KPF-ë nga Xhejlane Behluli.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: sa i perket kësaj pike për rend dite është e vertet që në KPF e kam propozu, arsyetimi ka qenë se shumë qytetarë nga fshati Stanishor kanë bërë shumë kërkesa për infrastruktur dhe të gjitha janë të protokoluara por asnjë pergjigje nuk kanë marrë. Të njejtën kohë perveq rrugëve të shtruara në fshatin Pasjak ne po votojm asfaltim të rrugëve por shaktat kush me i rregullu, po zgjidhet një problem ndërsa po del problemi tjetër, prandaj kam kerkuar raport dhe nuk e di se kush e ka pergjegjësin por nuk është në rregull, është shqetësuese si për fshatin Stanishor ashtu edhe Pasjak, perseri nuk ka zyrtar që na raporton por le ta mbajn pergjegjësin vet.

Ramush Mehmeti tha: mendoj se kërkesa është e arsyeshme por unë kisha kerku pasi që në vitin 2018 ne kemi ndarë nga të hyrat vetanake për ndriqim në fshatin Pasjak 29,000€, është mirë të ngritet kjo qështje se ku kanë shkuar ato mjete?. Kem probleme tjera, buxheti është aprovuar në shtator dhe tash ka filluar asfaltimi i disa rrugëve, heret është dasht të fillojn procedurat e të asfaltohen rrugët e jo kur edhe kushtet atmosferike nuk janë të mira. Siç u paraqit problemi me transport të nxënësve tash po paraqitet edhe me

projekte kapitale. Ligji thot se Kryetari është obligativ me raportu 2 her para Kuvendit në vit e jo asnjëher me marrë pjesë në seanc te Kuvendit, ju faleminderit.

Nexhat Mehmeti tha: kishte me qenë mirë me na sjell ai vendim edhe neve antarëve të Kuvendit se nashta e kemi harruar atë por e dim se nuk është e vertet, ne e dim se si është votuar heren e kaluar dhe kush paguan më së shumti tatim, shumë është me rendesi që ju si Kuvend me bashkpunu me shumë më egzekutivin dhe kështu zgjedhen problemet e qytetarëve.

Ramush Mehmeti tha: në janar të viti 2018 nuk ka qenë buxhet i projekteve por buxhet i të hyrave vetanake, unë e di shumë mirë se si është propozuar dhe si është votuar, vendimet egzistojnë dhe shumë mirë me kujtohet se ka qenë ndriqimi në Pasjak prej të hyrave vetanake.

Xhejlane Behluli tha: është e vertete se në vitin 2018 kur është bërë ky propozim ka qenë edhe Kryetari Svetislav Ivanovic në KPF-ë dhe janë ndar 30,000€ prej një kodi në kodin tjetër, une e kam pyetur Kryetarin atëher se a janë këto mjete edhe për fshatin Pasjak, nuk e ka specifiku se për cilin fshat do të ndahen por vetem se për ndriqim publik, kështu që janë ndar mjetet por nuk është cek fshati Pasjak, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: është problem me funksionu edhe Kuvendi dhe qeverisja në këtë mënyrë, Kuvendi është duke e kryer detyren e vete pasi që merr pjesë dhe kerkon llogari prej institucionit qeverisës Komunës, është problem perderisa si kemi Drejtorat prezent ku mundemi të kerkojm një pjesë të pergjegjesis së tyre, qeverisja Komunale po e shfrytëzon mundësin pasi që në mbledhje vjen vetem Drejtori i Financave për me kalu qoftë buxhetin ose diçka tjetër ndersa kur kerkojm ne raport prej tyre asnjë nuk është këtu, në një farë mënyre ne po e tregojm bashkpunimin por Kryetari dhe Drejtorat nuk marrin pjesë në seanc dhe kështu ka më shku vetem tu u thellu, ne e bëjmë punën tonë qoftë si opozit dhe asambleist ne kemi me kerku çdo herë llogari çdo herë në çdo moment dhe kohë, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu tha: te pika e ndriqimit publik në Pasjak ne e dim se njëherë është aprovuar e çka ka ndodh me ato mjete ne nuk e dim, normal ne si asambleist nuk kemi faj por kan faj zyrtarët e financave. Sa i perket inateve ne inate politike kemi por inate personale nuk kemi me askend.

Bajrush Ymeri tha: zt.Kryesusi u nxita pak nga fjalët e Nexhatit dhe Abdylit, vërtet e kemi një situat të palakmueshme në Kuvend tash e një kohë të gjatë, është krijuar një lloj armiqësie në mes të Kuvendit dhe ekzekutivit pa nevoj, sepse interes i përbashkët edhe i ekzekutivit edhe i Kuvendit si dhe i legjislativit është qytetari, nese ne kemi bashkpunim të mirë në mes veti perfitojn drejperdrejt qytetarët, po e shihni se sa pika kalum dhe në mungesë të Drejtorëve nuk bëme asnjë zgjidhje. Pra Kuvendi është juridikisht tu funksionu për arsye se ju po i thirrni mbledhjet me rregull, po i dergoni ftesat me rregull, perkthimi është në rregull, gjithqka është në rregull por faktikisht nuk është duke funksionuar pasi që i gjithë diskutimi po mbetet brenda këtyre katër mureve dhe shumë probelem po mbeten pa u zgjidh, andaj unë ju lus që të ulemi këto armiqësi, këto dallime që i kemi me mujt me i tejkalu pasi që asnjë nga ne nuk kemi interesa personale, i gjithë interesi është për qytetarët e Komunës tonë, ju faleminderit.

Zymer Zymeri tha: Kryetari po thot me bashkpunu por ne spo kemi se me kend me bashkpunu, unë kisha propozu që në muajin e ardhshëm mos të mbajm mbledhje por të protestojmë. Më vjen marre kur më pyet dikush se kush është Drejtori i Arsimit ose i Shendetësisë dhe nuk e di pergjigjen pasi që nuk marrin pjesë në mbledhje asnjëher.

Pika e gjashtë: Të ndryshme.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Sercan Todorovic tha: e kam një kerkes nga ju, unë si Drejtor ju njoftoj se 20,000€ i kemi planifikaur vitin e kaluar për vaksionim të kafshëve dhe nuk po kemi mundësi ti shpenzojm këto mjete andaj kerkoj që ti bartim këto mjete për subvencionim për mjete bujqësore për fermeret pasi që nese nuk i bartim këto mjete atëher shkojnë në suficit, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: nuk pajtohem me këtë propozim pasi që këto mjete më shum po i marrin ata që jetojnë në Serbi e jo që jetojnë në Kosovë, ju faleminderit.

Mirjana Simijonovic tha: nuk pajtohem me këtë propozim pasi këto paisje bujqësore duhet ti marrin ata që jetojnë këtu e jo si ka ndodhur më heret ti marrin e ti shesin por ti marrin ata që më të vërtet i perdorin dhe kan nevoj për këto mjete, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli tha: Kryesues me knaqësi ju kisha perkrah por nuk është hera e parë që i bini kështu pikat, ju si Drejtor në bazë të përvojës që e keni duhet ti dini datat se deri kur keni afat ti shfrytëzoni, në mënyr që të dim më qartë se ku po shkojnë ato mjete le të vij në rend ditë më herët.

Nexhat Mehmeti tha: unë mendoj se këtu kishe qenë mirë më fol antarët më të vjetër që kanë përvojë, pse nuk po thuani se po i ndajm mjetet por Kuvendi të dij se kush po perfiton e jo vetem spo i ndajm atëher këto mjete po i merr qeveria, andaj kerkoj që ta përkrahni Drejtorin pasi që Drejtori shumë mirë e ka që mos me i humb këto mjete.

Milica Jovanovic tha: ne jemi të ri por po e shohim situaten në teren, ne kemi formuar një komision për ndarje të kafshëve familjeve të dëmtuar nga vjedhjet e kafshëve dhe ai komision fare nuk ka funksionuar as nuk është pyetur asgjë.

Mirjana Simijonovic tha: ju keni të drejtë se duhet të bashkpunojmë por të gjithë e dim se sa komisionet janë formuar e sa herë ka qenë Kryetari që të bashkpunoj, është formuar komisioni për emërimin e rrugëve, vetem në Komunën tonë nuk janë emëruar rrugët, është formuar komisioni për blerjen e kafshëve familjeve të dëmtuara nga vjedhjet por asnjëher nuk ka raportuar.

Xhejlane Behluli tha: faleminderit Nexhat për kshillen, e kam votuar për heren e kaluar dhe përsëri do të votojm pasi që është interes i qytetarëve por kerkoj që mos të ndodhë më kështu çdo herë ta presim afatin e fundit për bartje të mjeteve, më mirë të njoftohemi më heret të diskutojmë, ti propozojm emrat edhe prej Kuvendit në mënyrë që ta dim se kush po furnizohet me ato mjete në mënyrë që mos të ketë keqpërdorime.

Dobriroje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimisht pajtohem që ato mjete të mos kthehen në qeveri më mirë të ndahen disa koltivator për fermerët, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: është afati i fundit andaj është më mirë të marr dikush diçka se të shkojnë këto mjete në suficite të mos merr askush asgjë.

Driton Abdyli pasi pershendeti të pranishmit tha: seriozisht me këto mjetet e bujqësisë është bërë kjo punë monoton që 6 vite, në vitin 2013 kam qenë Kryesor kur është formuar ky program por që 6 vite është bërë monoton duke perfitu të njëjtit por për mos me shku këto mjete suficit më mirë është me marr perseri dikush diçka.

Zymer Zymeri tha: unë e perkrahi që të barten këto mjete por pse vetem në bujqësi, pse spo i bartim këto mjete për bursa ose të bëjm një pauz prej 15 min e të vendosim se ku po i bartim këto mjete. Ka periftues që 10 herë ka marr paisje bujqësore ndërsa ka që nuk kan marrë asnjëher.

Mirjana Simijonovic tha: zt.Drejtor a keni informat se sa njërz janë shpengul?, a e dini se sa qytetar nga Koretishta janë shpengul, çdo her perfitojn personat e njëjt e kjo dikush që ka nevoj e i shfrytëzon ato paisje, më mirë që të shkojnë ato mjete suficit se të jenë qytetarët e paknaqur.

Sercan Todorovic tha: nuk mund të barten këto mjete për bursa pasi që janë në kod të Drejtorisë së Bujqësisë dhe vetem në bujqësi duhet të barten.

Ramush Mehmeti tha: plotësisht keni të drejt se çka po diskutoni, nuk kam koment se çka me ju thënë por probelmi është kështu, nese ju po mendoni mos ta perkrahni është në rregull por më mirë të perfitojn disa qytetarë sesa të shkojnë të gjitha mjetet në suficit, është afati i fundit për bartjen e këyre mjeteve andaj ju lus që ta perkrahni të gjithë, ju faleminderit.

Jahi Zeqiri tha: paknaqësit nuk kanë qenë mes qytetarëve që jan shpernda ato pajise bujqësore por kanë qenë mes qytetarëve dhe zyrtarëve Komunal, pasi që ato paisje që janë nda rreth 95% janë nda në zyrtarë Komunal, çdo i dyti zyrtarë Komunal ka marrë koltivator, mirë është ato mjete mos me u kthy prap e me u bartë ato mjete por paisjet me u nda qytetarëve që kanë nevoj dhe që i shfrytëzojnë.

Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesi tha: e dim se si ndahen subvencionet dhe të gjithë ju jeni deshmitar se si janë nda në kohën e Bajrush Ymerit dhe se si ndahen tani. Nga raporti i auditorit kemi parë se edhe nga Komuna e Gjilanit që kanë marrë mjete.

Abdyl Gashi tha: është e vërtetë se mjetet që janë nda edhe janë keqperdor por duke e pas parasysh që këto mjete mos të shkojnë suficit, propozoj që ta formojm një komision nga Kuvendi dhe ti percjellim ato lista para se me i nda subvencionet si dhe të kemi një pasqyr se kush po mer nga dy a tri herë e dikush asnjëher në mënyr që mos të shkojë suficit.

Nexhat Mehmeti tha: vetëm të nderlidhem sa për informacion është e vërtetë se dikush ka perfituar nga dy apo tri herë por kusht është me u pagu 30% dhe ai person që paguan 30% është pak serioz si dhe duhet ta ketë letërnjoftimin e Komunës së Novobërdës.

Dobrivoje Djordjevic tha: i falenderohem Drejtorit të Financave pasi që merr pjesë në çdo mbledhje, por të gjithë e dim se Drejtori nuk vendos se kujt i ndahen këto mjete andaj hudhëni në votim dhe ta përfundojm këtë diskutim.

Mirjana tha: kërkoj pauz 5min dhe të vendosim.

Kryesuesi tha: pauz 5min.

Pas pauzes 5 minuteshe Kryesuesi tha: e hudhi në votim propozimin e Drejtorit të Financave.

Me 9 vota për, 3 kunder (Nebojsa Arsic, Milica Jovanovic, Mirjana Simijonovic) dhe 1 apstenim nga antarët prezent të Kuvendit aprovohet ky:

VENDIM

Me këtë vendim barten mjetet financiare nga kodi buxhetor i Bujqësisë 47030, nga fondi burimor (10) Projekti vaksionimi i bagetive në tërë teritorin e Komunës së Novobërdës, kodi i projektit 48987, Mjetet të rialokohen në Drejtorin e Bujqësisë në projektin Blerja e paisjeve bujqësore për fermer kodi i projektit 44966.

Jahi Zeqiri tha: unë kam bërë një lëvizje prej subjektit të LDK-së në AAK-ë andaj kërkoj nga Kuvendi që të ndrrohet emri i subjektit politik dhe të respektohet vullneti imë, nga sot nuk jam pjesë e partisë së LDK-së, ju faleminderit.


Zymer Zymeri tha: Kryesues ne e kemi marr në Kuvend një vendim por nuk e ke zbatuar, ne kemi marrë vendim që të vizitojm një vend dhe ju duhet ti zbatoni vendimet. Qështja tjetër ka të bëjë me furnizimin me dru në shkollën e fshatit Koznic, e kanë sjell një kamion me dru dhe ka thënë se janë 15m dru ndërsa kur janë shkarkuar e kemi parë se nuk janë as 6m dru.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

